

UNMIK/REG/2007/15

19 mars 2007

RREGULLORE NR. 2007/15

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2006/6 MBI
INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke i kushtuar vëmendje të duhur Kapitullit 10 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 të datës 16 shkurt 2006 mbi Institucionin e Avokatit të popullit në Kosovë,

Pas konsultimeve me Kuvendin e Kosovës dhe me Qeverinë,

Me qëllim të ndryshimit të neneve 5, 6, 8.1, 8.2, 8.4 (a), 8.4 (c), 12.1, 18 dhe 19 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 për të lehtësuar procesin e emërimit të Avokatit të popullit dhe të zëvendësve të tij,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshimet

1.1 Neni 5 ndryshohet si në vijim:

Neni 5
Përbërja e Institucionit të Avokatit të popullit

Institucioni i Avokatit të popullit përbëhet nga Avokati i popullit, katër (4) zëvendës të Avokatit të popullit dhe nga stafi kompetent profesional. Avokati i

popullit i cakton përgjegjësitë e zëvendësve të tij dhe njërin prej tyre e cakton si zëvendës kryesor të Avokatit të popullit.

1.2 Neni 6 ndryshohet si në vijim:

Neni 6
Avokati i popullit dhe zëvendësit e tij

6.1 Avokati i popullit dhe zëvendësit e tij duhet të jenë personalitete të njohura me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe me integritet, me përkushtim të dëshmuar për të drejtat e njeriut dhe të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës.

6.2 Avokatin e popullit e emëron Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente të votimit me përkrahjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës, pas njoftimit publik të bërë nga Kryesia e Kuvendit me të cilin u bëhet thirrje organizatave dhe institucioneve të cilat merren me mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që të bëjnë emërimet brenda një periudhe jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë. Nëse shumica e nevojshme nuk sigurohet pas një votimi të veçantë për secilin kandidat, Kryesia e Kuvendit ka mundësinë e zgjedhjes për ndërprerjen e votimit dhe rifillimin e sërishëm të procesit të propozimeve.

6.3 Mandati i Avokatit të popullit do të jetë katër (4) vjet. Emërimi mund të përtërihet edhe për një mandat tjetër.

6.4 Katër (4) zëvendësit e Avokatit të popullit i emëron Kuvendi i Kosovës, në bazë të procedurave të hapura dhe transparente të një votimi të vetëm kolektiv me përkrahjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës të pranishëm të cilët votojnë, përfshirë votat e së paku $\frac{1}{4}$ të deputetëve të Kuvendit (30), në bazë të rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i popullit, pas njoftimit publik të bërë nga Kryesia e Kuvendit me të cilin u bëhet thirrje organizatave dhe institucioneve të cilat merren me mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore që të bëjnë emërimet brenda një periudhe jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë. Pas emërimit të zëvendësve të Avokatit të popullit, njëri prej tyre do të caktohet në mënyrë zyrtare nga Avokati i popullit që të shërbejë si zëvendësi kryesor i tij. Nëse posti i njërit prej zëvendësve lirohet, Kuvendi do të votojë për një kandidat për të plotësuar postin bazuar në rekomandimin e Avokatit të popullit, në pajtim me kushtet e votimit dhe me procedurat e emërimit të paraqitura në këtë paragraf.

6.5 Mandati i katër (4) zëvendësavokatëve të popullit është tri (3) vjet. Emërimi mund të përtërihet edhe për një mandat tjetër.

6.6 Në kuadër të personave të emëruar në postin e Avokatit të popullit dhe të katër zëvendësve të Avokatit të popullit së paku një (1) do t'i përkasë komunitetit shumicë shqiptare të Kosovës, së paku një (1) do të jetë prej komunitetit serb të Kosovës dhe së paku një (1) do të jetë prej njërit nga komunitetet e tjera joshumicë që janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Personat e emëruar shërbejnë në cilësinë e tyre

individuale dhe bashkarisht e përfaqësojnë shumëllojshmërinë etnike të shoqërisë kosovare.

6.7 Në kuadër të personave të emëruar në postet e Avokatit të popullit dhe të katër (4) zëvendësve të tij duhet të përfshihet së paku një (1) femër.

6.8 Kuvendi i Kosovës në përputhje me rregulloren e tij të punës i miraton procedurat formale të cilat duhet të jenë të hapura dhe transparente. Këto procedura duhet të marrin parasysh në mënyrë të posaçme kriteret e përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni për përfaqësimin e komuniteteve dhe në paragrafin 7 të këtij neni lidhur me barazinë gjinore.

6.9 Nëse interesimi përkitazi me konkurset publike në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni nuk ia mundëson Avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij që t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni për përfaqësimin e komuniteteve si dhe në paragrafin 7 të këtij neni lidhur me barazinë gjinore, Kryesia e Kuvendit mund t'i rekomandojë Kuvendit që një ose më shumë poste të zëvendësve të Avokatit të popullit të mbahen të paplotësuara dhe që të bëhen thirrje të tjera për emërimë derisa të plotësohen kriteret e përcaktuara në paragrafët 6 dhe 7.

6.10 Mandati i Avokatit të popullit dhe i zëvendësve të tij përfundon me rastin e skadimit të tij, të dorëheqjes, të vdekjes apo të largimit të tij nga detyra nga ana e Kuvendit të Kosovës, siç parashihet me nenin 8 të kësaj Rregulloreje. Kryesia e Kuvendit e shpall konkursin publik për të plotësuar pozitën e lirë të Avokatit të popullit ose të zëvendësit(ve) të tij brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve prej përfundimit të mandatit përkatës.

6.11. Pas emërimit, Avokati i popullit dhe zëvendësi(t) e tij japin betimin solemn me nënshkrimin e tyre para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit është si në vijim: “Unë solemnisht deklaroj dhe premtoj se me besnikëri do t'i kryej detyrat dhe funksionet që më janë besuar me ligj për t'i mbrojtur dhe avancuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Kosovë, se do t'i kryej detyrat e mija në tërësi e në mënyrë të paanshme dhe se as nuk do të kërkoj as nuk do të pranoj udhëzime nga çfarëdo burimi i jashtëm”.

1.3 Neni 19 ndryshohet si në vijim:

Neni 19
Dispozitat kalimtare dhe shfuqizimi

19.1 Institucioni i Avokatit të popullit do të themelohet pas emërimit të Avokatit të popullit dhe të katër (4) zëvendësve të tij sipas kësaj Rregulloreje. Nëse ka një apo më shumë vende të lira në rrethanat e përshkruara në nenet 6.4 dhe 6.9 të kësaj Rregulloreje, Institucioni i Avokatit të popullit, megjithëkëtë, do të konsiderohet ligjërisht i themeluar.

19.2 Në pritje të emërimit të Avokatit të popullit dhe të zëvendësve të tij, zyrtarët e emëruar në këto poste në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje mbesin përkohësisht në të njëjtat poste dhe i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë, në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/38 të datës 30 qershor 2000 për themelimin e Institucionit të Avokatit të popullit në Kosovë.

19.3 Në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, personi që është zëvendës i Avokatit të popullit mund të emërohet si Avokat i popullit sipas nenit 6.2 apo si zëvendës i Avokatit të popullit sipas nenit 6.4, dhe emërimi i tillë mund të përtëritet edhe për një mandat tjetër, në pajtim me nenin 6.3 apo me nenin 6.5.

19.4 Rastet e shkeljeve të supozuara të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve të Kosovës, të cilat vetëm pak para themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë akoma duke u hetuar prej Institucionit të Avokatit të popullit të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38 apo prej zëvendësve të Avokatit të popullit, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, pas themelimit të Institucionit të Avokatit të popullit do të kalojnë në përgjegjësinë e Institucionit të Avokatit të popullit të themeluar sipas kësaj Rregulloreje.

19.5 Përveç kur parashihet si në paragrafin 2 të këtij neni, Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2000/38 e datës 30 qershor 2000 mbi themelimin e Institucionit të Avokatit të popullit në Kosovë shfuqizohet në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

1.4 Në nenet 8.1, 8.2, 8.4 (a), 8.4 (c), 12.1 dhe 18 fshihen fjalët “Zëvendës kryesor i Avokatit të popullit”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 19 mars 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm